

fshatrat fqinjë. Në datën 20.09.1998, forcat serbe e sulmuan fshatin. Fadili e ka marr dhe e ka strehuar familjen e vet te Qerim Halilaj në Tërdec/Trdevac, ndërkaq ai vet u kthye në Negroc/Negrovce. Dhjetë ditë më vonë, kur familjarët e tij u kthyen në fshat, bashkëshortja e Fadilit, Fatimja, mësoi nga pjesëtarët e UÇK-së se Fadilin e kishin vrarë më **25.09.1998** në fshatin **Vuçak/Vučak**. I thanë se Fadili kishte rënë në pusi të forcave serbe. Më 30.09.1998, ai u varros në varrezat e Negrocit/Negrovce. Në datën 5.09.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Fadilit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce.

Burimet: deklarata F.K, FDH-31848; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Ilaz (Maliq) Javori

(01.05.1962, shqiptar nga Llozica/Lozica, komuna e Malishevës/Mališevo, punëtor, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Skënder (Liman) Shala

(20.08.1977, shqiptar nga Vuçaku/Vučak, komuna e Gllgocit/Glogovac, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Skënderi punonte në ndërtimtari. Nga mesi i vitit 1998, ai u bë anëtar i UÇK-së në fshatin Negroc/Negrovce. Në fillim të angazhimit të tij ushtarak, ai e mbante rojën te varrezat e fshatit, ndërkaq më vonë kaloi te pozicionet e UÇK-së në Llapushnik/Lapušnik. Ilazi me familje jetonin në fshatin Llazicë/Lozica. Edhe ai punonte në ndërtimtari. Në datën **26.09.1998**, Skënderi dhe Ilazi kanë rënë në betejë me forcat serbe që u zhvillua në një pyll përmbi fshatrat e **Bajicës/Banjica** dhe Vuçakut/Vučak. Ditën e nesërme, të afërmit e Skënderit i kanë sjellë trupat e Skënderit dhe Ilazit në fshat. U varrosën në varrezat e fshatit Vuçak/Vučak. Në muajin shtator të vitit 1999, mbetjet mortore të Skënderit dhe Ilazit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce, ndërkaq, në nëntorin e vitit të njëjtë, familjarët e Ilazit i kanë transferuar mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo.

Burimet: deklarata E.S, FDH-28122; deklarata E.S, FDH-31847; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Fatos (Sherif) Krasniqi

(10.09.1970, shqiptar nga Negroc/Negrovce, komuna e Gllgocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Fatosi ka marr pjesë aktivisht në demonstratat kundër shuarjes së autonomisë politike të Kosovës. Në muajin mars të vitit 1998, ai ka aderuar në UÇK-në. E ka humbur jetën në luftimet me forcat serbe që janë zhvilluar më **26.09.1998**, në vendin e quajtur *Kozmaq* në fshatin **Negroc/Negrovce**. E kanë varrosur menjëherë ditën tjetër në varrezat e Negrocit/Negrovac. Saktësisht një vjet më vonë, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Negroc/Negrovce. Në përkujtim të tij, fshatarët e kanë riemërtuar fshatin e tyre me emrin e Fatosit.

Burimet: SHFDUÇK, *Feniksët...*3, 39-42, FDH-24476; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 117, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Sofije (Adem) Dubovci

(28.3.1960, shqiptare nga Çikatova e Vjeter/Staro Čikatovo, komuna e Gllgocit/Glogovac, dy fëmijë)

Sofija, bashkëshorti i saj Xheladini dhe djemtë Ylberi dhe Fitimi jetonin në fshatin e **Çikatovës së Vjeter/Staro Čikatovo**. Ajo vuante nga çrregullimet psikike. Për këtë arsye shpesh i frekuentonte mjekët. Në mëngjesin e datës **26.09.1998**, ajo me burrin Xheladinin u nis te mjeku në Gllgoc/Glogovac. Shkonin përmes livadheve të fshatit. Pjesëtarët e policisë serbe, të cilët ishin të stacionuar në fabrikën e *Ferronikelit*, kanë shtënë drejt tyre duke e qëlluar Sofijen. Ajo ra në tokë. Xheladini i dha vrapit dhe arriti që të arratisë. Familjarët nuk kishin guxim të shkonin ta merrnin trupin e Sofijes deri te përfundimi i luftës. Shkuan në vendin e vrasjes vetëm pas lufte, por nuk e gjetën trupin e saj. Pjesëtarë të KFOR-it i kanë gjetur mbetjet